

V E N D I M
Nr. 326, datë 27.6.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 358, DATË 28.7.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE TË
DOGANAVE”, ME NDRYSHIMET PËRKATËSE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 e 6 të ligjit nr. 8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës” dhe të pikës 4 të nenit 13 të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999 “Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 358, datë 28.7.1999 të Këshillit të Ministrave, me ndryshimet përkatëse, të bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1 shkronja “a”, paga e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave bëhet 71 900 lekë në muaj dhe në shkronjën “b”, paga e Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Doganave bëhet 53 600 lekë në muaj.

b) Lidhja nr. I “Struktura e pagës së doganave” dhe lidhja nr. 2 zëvendësohen me lidhjet me të njëjtin numër, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondet e miratuara për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 16 korrik 2002.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

LIDHJA NR.1
STRUKTURA E PAGËS SË DOGANAVE

Emërtimi	Paga mujore				
	Paga individuale			Shtesa e profesionit	
Kategoria	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (në %)	Shtesa për kualifikim (në %)	Shtesa për pozicion në lekë	Shtesa për kushte pune në lekë
A Drejtor Drejtorie në Departament Drejtor Drejtorie Rajonal	1	2% e PG për çdo vit pune		26 710	14 680
B Përgjegjës Sektori Kryetar Dege Inspektor	1	2% e PG për çdo vit pune		21 170	12 760
C1 Specialist, Hetues dogane Drejtues turni	1	2% e PG për çdo vit pune		13 350	11 915
C2 Doganier	1	2% e PG për çdo vit pune		10 500	9 790
C2 Doganier	3	2% e PG për çdo vit pune		10 500	8 760
D1 Doganier, shofer, regjistruar, sekretare, magazinier, operator, laborant	3	2% e PG për çdo vit pune		8 580	8 760
D2 Centralist. Sportelist.	3	2% e PG për çdo vit pune		8 580	8 760
Sanitar.Punëtor mirëmbajtje	4	2% e PG për çdo vit pune		4 930	2 120

LIDHJA NR.2

Grupi	Paga në lekë
1	9 720
2	8 640
3	6 480
4	3 890